



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:079010
Datë: 11.07.2024
Numri i dokumentit: 05923888

C.nr.2019:079010

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren Mirjeta Shala, në çështjen kontestimore të paditësit Rr. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Feride Xani, avokate nga Gjakova, kundër të paditurit P. Gj. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Prek Kola, avokat nga Gjakova, me objekt kontesti për kthimin e borxhit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 22.05.2024, mori ndërsa me datë 11 korrik 2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Rr. B. nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që *“Të obligohet i padituri P. Gj. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, paditësit Rr. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, t’i kthen shumën e të hollave prej 40.000.00 (katërdhjetë mijë) Euro në emër të borxhit, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit, duke llogaritur prej datës 21.11.2018 si ditë e paraqitjes së kësaj padie e deri te pagesa përfundimtare.”*
- II. DETYROHET paditësi Rr. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës që në emër të shpenzimeve procedurale të paditurit t’ia paguaj shumën prej 3,120.00 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi Rr. B., në këtë gjykatë me datë 21.11.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurit P. Gj. për kthimin e borxhit, duke theksuar ndër të tjera se paditësi të paditurit me datë 30.01.2015 i ka dhënë hua shumën e të hollave prej 40.000.00 (katërdhjetë mijë) Euro dhe ato i ka dhënë në zyrën e të paditurit pranë subjektit afarist N.T.P “ . . . ” në Gjakovë, e cila gjendet në Rr. “ . . . ”, në Gjakovë, në dalje të qytetit në drejtim të fshatit Trakaniq. Këto të holla i a dhënë për kohë të caktuar përkatësisht për 6 muaj dhe këto të holla janë dhënë pa ndonjë interes si dhe i padituri i

ka premtuar dhe garantuar që me kohë do të ia kthen të hollat e marrura hua (borxh). Pas kalimit të afatit për kthim (6 muaj) i padituri nuk i ka kthyer të hollat e marrura si dhe fare nuk është lajmëruar tek paditësi për vonesat eventuale. Paditësi, pas kalimit të afatit disa herë e ka kontaktuar të paditurin dhe ka kërkuar kthimin e të hollave, në çdo takim të paditësit i padituri ka gjetur arsye që të i shmanget obligimit për kthimin e të hollave, me gjasë as që e ka ndërmend në mënyrë vullnetare të i kthej, andaj paditësi i ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktgjykim me të cilin obligohet i padituri P. Gj. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, që në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, paditësit Rr. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, t'i kthen shumën e të hollave prej 40.000.00 (katërdhjetë mijë) Euro në emër të borxhit, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit, duke llogaritur prej datës 21.11.2018 si ditë e paraqitjes së kësaj padie e deri te pagesa përfundimtare.

I padituri P. Gj. me datë 24.12.2018 ka paraqitur përgjigje në padi duke theksuar se pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë, absolutisht janë të pavërteta, duke filluar nga shuma e të hollave, mënyra e marrjes dhe vendi ku janë marrur dhe se e siguroj gjykatën se me provat që do të i propozoj gjatë gjyqimit padia e paditësit është tërësisht e pabazë, është vetëm një trillim dhe mënyrë që të më detyron të paguaj kamatë mbi kamatë. Kërkoj nga gjykata që padinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar dhe ta detyron që të mi paguan shpenzimet e mia të shkaktuar me këtë padi.

Kjo gjykatë me Aktgjykimin C.nr. 771/2018, të datës 01.04.2020, padinë e paditësit Rr. B. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës e ka refuzuar në tërësi si të bazuar, ndërsa ndaj të njëjtit aktgjykim, i padituri ka parashtruar ankesë me datë 13.05.2020 për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, me Aktvendimin Ac.nr. 3370/2020 të datës 01.09.2023, ka aprovuar ankesën e të paditurit dhe ka PRISHUR Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.771/2018, të datës 01.04.2020, duke ia kthyer të njëjtës gjykatë lëndën në rishqyrtim dhe vendosje.

E autorizuar e paditësit avokate Feride Xani deklaroi se mbetem në tërësi pranë kërkesës së parashtruar në padi, gjithashtu i mbështes edhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit. Kërkoj nga Gjykata, që sipas rekomandimeve të kësaj Gjykate, të evitohen të metat e aktgjyqimit të shkallës së parë, sa i përket faktit se paditësi disa herë ka kërkuar nga i padituri kthimin e borxhit, i njëjti ka premtuar se në afat sa më të shkurtër do ta përmbush këtë obligim, gjë që gjykatës i propozoj që palët ndërgjyqëse të dëgjohen në cilësi të palës, e cila do të vërtetoj se në këtë çështje nuk ka parashkrim si dhe të definohen saktë qëndrimet e palës së paditur, pasi që në bazë të procesverbaleve të seancave të kaluara, kanë qenë mjaftë kundërthënëse lidhur me versionin e marrjes së kësaj shume. Sa i përket provave të cilat janë nxjerrë, nuk propozoj që të njëjtat të nxjerrën përsëri, por vetëm të lexohen procesverbalet e shqyrtimeve kryesore, ku janë nxjerrë këto prova. Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë e njëjta ka të bëjë me kthimin e borxhit.

I autorizuar i të paditurit avokat Prek Kola deklaroi se mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë deklarimeve në seancat e kaluara. Po ashtu, shtoj se sa i përket pretendimeve në padi, konsideroj se të njëjtat janë vetëm deklarative po ashtu afati për kthimin e të hollave për të cilat pretendon paditësi është parashkruar, nën supozimin se ekziston ky borxh, po ashtu mungon

edhe legjitimiteti pasiv i palës së paditur në këtë procedurë, pasi sipas marrëveshjes të datës 30.01.2015, ku është nënshkruar vetëm nga njëra palë që supozohet se është pala e paditur P. Gj., në këtë marrëveshje është cekur edhe subjekti juridik N.T.P “... Gjakovë”, që nga kjo nuk dihet se cila duhet të jetë palë në procedurë, pra subjekti juridik apo personi fizik. Andaj, duke u bazuar edhe në rekomandimet e Gjykatës së Apelit, propozoj gjykatës që në këtë procedurë të rigjykimit të ftohen prapë dëshmitarët të cilët më herët janë dëgjuar pasi edhe në deklaratat e tyre të mëhershme ka pasur paqartësi dhe mos përputhje të deklarimeve mes këtyre dëshmitarëve, të ftohen pra edhe një herë në rigjykim.

Në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim e autorizuara e paditësit avokate Feride Xani ndër të tjera ka theksuar se mbetem në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të dorëzuar pranë kësaj gjykate me datë 09.01.2020 si dhe qëndrojmë pranë deklarimeve dhe padisë, ky fakt u vërtetua edhe në shqyrtimin kryesor të datës 20.05.2024 ku në cilësinë e palës u bë dëgjimi i palëve ndërgjyqëse nga të cilat u vërtetua se paditësi deri para se të ushtroj padinë në vazhdimësi e kishte kërkuar borxhin nga i padituri por se i njëjti e kishte shtyer afatin e kthimit duke i japur arsytetime të ndryshme si në procesverbal të datës 20.05.2024 faqja 4 (11) të njëjtën e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët përkatësisht dëshmitari V.D. i cili është në relacion familjar me të paditurin dhe i njëjti kishte ndërhyrë që paditësi të ia jap shumën e të hollave prej 40,000.00 Euro të paditurit duke e siguruar se paratë do t’i kthehen brenda 6 muajsh. Edhe pse me disa versione deri më tani dhe pretendime të ndryshme për t’i ikur këtij obligimi duke pretenduar se nuk i ka marrë të hollat nga paditësi i njëjti prandaj se e ka hartuar marrëveshjen dhe se në vazhdimësi ka kontaktuar me paditësin përmes telefonit, gjë që e vërteton faktin se paditësi në vazhdimësi e ka kërkuar borxhin edhe personalisht tek i padituri edhe përmes telefonit deri para ngritjes së padisë në gjykatë, për ta vërtetuar këtë fakt i kemi propozuar gjykatës që të nxjerren listingjet e thirrjeve të telefonatave në mes të palëve ndërgjyqëse çka do të vërtetonte faktin se paditësi në vazhdimësi ka kërkuar që t’i kthehet borxhi – të hollat e dhëna.

Në këtë çështje pas administrimit të të gjitha prova u vërtetua se nuk kemi të bëjmë me parashkrim por se padia e paditësit R.B. është brenda afatit dhe se janë plotësuar kushtet ligjore që kjo padi të aprovohet si e ligjshme dhe me mbështetje ligjore, i padituri obligohet në shpenzime të procedurës sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

I autorizuari i të paditurit avokat Prek Kola në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar se gjatë gjithë këtij shqyrtimi gjyqësor janë administruar shumë prova materiale dhe personale, në cilësinë e palës është ndëgjuar paditësi Rr. B. dhe i padituri P. Gj., janë dëgjuar dëshmitarët K.B., T.B., V.D. dhe L.Gj. ku nga dëshmitë e tyre dhe provat e administruara janë vërtetuar pretendimet e të paditurit se padia – kërkesëpafia është e pabazuar, se kinse paditësi Rr. B. i ka dhënë hua shumën e të hollave të paditurit P. Gj., po ashtu është vërtetuar fakti se edhe nën supozimin se ekziston borxhi për të cilin pretendon paditësi, afati për kthimin e këtij borxhi është parashkruar (vjetërsuar) ngase kanë kaluar më shumë se 3 vite nga dita ku thuhet se është bërë marrëveshja e nga dita kur është parashtruar padia nga ana e paditësit. Tutje ka shtuar se nga deklaratimet e dëshmitarit L.Gj. dhe deklarimi i vetë të paditurit P. Gj. është vërtetuar fakti se i padituri asnjëherë nuk e ka pranuar shumën e të hollave që e kërkon paditësi në kërkesën e tij, u vërtetua fakti se me paditësin kanë biseduar në zyrën e të paditurit NTP “...” lidhur me zgjerimin e aktivitetit bujqësor blerjes së viçave dhe se i padituri ka kërkuar nga paditësi që të siguroj mjete për blerjen e viçave, e të cilat mjete sipas bisedave gojore do të

sigurohen nga paditësi brenda 1-3, e cila do të të konkretizohen me shkrim pas sjelljes së të hollave para zyrës noteriale brenda 1-3 ditë nga marrëveshja gojore, me kusht që mjetet që do të jepen hua të i kthen i padituri në afatin prej 6 muajve nga dita e dhënies së huas, po ashtu u vërtetua fakti se paditësi asnjëherë nga dita e asaj marrëveshje nuk i ka sjellur të hollat në shumë prej 40.000.00 Euro, po ashtu u vërtetua fakti se marrëveshja e paraqitur nga ana e paditësit e datës 30.01.2015 e ka nënshkruar i padituri me kërkesën e paditësit që t'i arsyetoj të hollat tek familja dhe të afërmit e tij knise të hollat ja ka dhënë të paditurit për t'i mbuluar humbjet e të hollave të cilat ai e din se si i ka humbur, po ashtu nga deklarimi i të paditurit u vërtetua fakti se ajo marrëveshje nuk është jetësuar nga dy palët dhe nënshkruar nga të dy palët paditësi dhe i padituri, të cilin fakt e ka deklaruar edhe i padituri se unë nuk e kam lënë të nënshkruan Rr. deri në momentin se t'i bjen të hollat që marrëveshja të mos jetë vërtetuar se Rr. i ka dhënë të hollat, pasi mund të keqpërdoret kjo marrëveshje ashtu siç është keqpërdorur, po ashtu nga deklarimet e tyre u vërtetua fakti se paditësi ditën kur ka qenë në zyre për marrëveshje ka qenë vetëm dhe nuk ka qenë me personat e cekur si dëshmitarë e me çka kanë deklaruar se dëshmitarin T.G. nuk e kanë parë kurrë dhe as që e njohin si person, andaj deklarimeve të tyre gjykata duhet të ju falë besimin në tërësi sepse paditësi asnjëherë nuk i ka dhënë të paditurit të hollat për të cilat pretendon.

Ka vazhduar se gjykata nuk duhet të ju falë besimin deklarimeve të dëshmitarëve K.B., T.G., V.D. dhe dëshmisë së paditësit në cilësi të palës sepse dëshmitë e këtyre dëshmitarëve kanë qenë kontradiktore me njëri tjetrin sidomos sa i përket prezencës së personit L.Gj. dhe me vetë vetën dhe deklaratat e tyre, po ashtu deklarimet e tyre e vënë në pikëpyetje prezencën e tyre se ditën kur është bërë kinse marrëveshja a kanë qenë prezent, por deklarimet e tyre shihen qartë se kanë qenë të ndikuar nga paditësi që i ka përgatitur që të deklarojnë në seancë gjyqësore ashtu siç ka biseduar paditësi me të paditurin për marrëveshje pa prezencën e tyre, sepse dëshmitari K.B. në pyetjen e gjykatës përgjigjet se *“Ka qenë Rr, unë, V.D. dhe T.G. si dhe ka qenë personi L.Gj., mirëpo ai ka qenë punëtor dhe me rastin e dorëzimit të hollave nuk ka qenë në zyre”*, dëshmitari T.G. në pyetjen e gjykatës përgjigjet *“ se në zyrë ka qenë P., V., unë dhe K., ka qenë edhe një person tjetër mirëpo ai ka dal jashtë pasi i ka thënë P.”*, dëshmitari V.D. në pyetjen e gjykatës përgjigjet *“se jo nuk e di ndoshta ka qenë ndonjë punëtor i P.”*, ndërsa paditësi Rr. B. thotë se nuk ka qenë L., atëherë shtrohet pyetja cila është e vërteta. Po ashtu nga deklarimi i paditësit u vërtetua fakti se të hollat i ka kërkuar i padituri, i njëjti i ka kërkuar familjarëve të tij të cilëve ju ka thënë që këto të holla i i duhen për ndërtimin e shtallës së viçave dhe ky fakt jep të kuptojmë se paditësi është duke u munduar që gjykatën ta vë në lajthim me deklarimet e tij dhe kërkesën e tij, se njëherë thirret se ja ka dhënë të hollat të paditurit e një herë thotë se të hollat e kërkuara nga i padituri i ka siguruar nga të afërmit e tij kinse dëshiron të ndërtoj shtallën dhe nuk e ka vërtetuar me asnjë deklaratë të afërmeve të tij se i kanë dhënë ato të holla apo ndonjë dokument kinse i ka marrur ato të holla, por ka paraqitur një transaksion bankar në emër të K.B.t i cili fare nuk është palë në procedurë kinse ka marrur kredi për kthimin e borxhit familjarëve, këto veprime të paditësit dhe këto prova japin të kuptojmë që paditësi është duke u munduar që gjykatën ta vë në lajthim se kinse i padituri i ka borxh. Tutje ka shtuar se Gjykata duhet ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit për faktin se padia është e parregullt edhe nga aspekti subjektiv i palëve në procedurë sepse aty kemi vetëm një të paditur ndërsa në marrëveshje është edhe personi juridik NTP . . . dhe se gjykata nuk mund të vendos për një borxh dhe një kërkesë të tillë kur mungon si palë subjektive – pasive në procedurë edhe NTP . . . , po ashtu në

marrëveshje është e përfshirë edhe vula e NTP “. . .” me pronar L.Gj., me çka paditësi nuk e ka përfshirë si palë në procedurë edhe NTP . . . , për të përcaktuar drejtë kërkesëpadinë e tij, pra me të gjitha këto të meta nuk mund të vërtetohet kërkesëpadia e paditësit. Po ashtu ka theksuar se në rastin konkret edhe nën supozimin se ekziston ky borxh padia e paditësit është parashtruar jashtë afatit ligjor pasi kanë kaluar mbi 3 vite nga marrëveshja për të cilën pretendon paditësi pasi sipas deklarimeve të paditësit dhe të paditurit dhe dëshmitarëve afati ka qenë 6 muaj për me i kthyer të hollat nga data e marrëveshjes e datës 30.01.2015, me çka paditësi e ka parashtruar padinë me datën 21.11.2018 ndërkaq marrëveshja është bërë me datë 30.01.2015 dhe duke llogaritur edhe afatin e kthimit prej 6 muajve nda data 30.01.2015 ky borxh është vjetërsuar (parashkruar) me çka gjykata bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) duhet që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të parashkruar. Përfundimisht gjykatë së faktit i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit Rr. B. të e refuzon në tërësi si të pabazuar dhe të pasafatshme (parashkruar) si dhe të obligon paditësin të paguaj shpenzimet procedurale dhe njëkohësisht i kërkoj shpenzimet procedurale sipas tarifës së avokatëve dhe atë për përgjigje në padi 208 Euro, përgjigje në ankesë 208 Euro, për 10 seanca të mbajtuara nga 260.40 Euro=2,740 Euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 3,120.00 Euro.

- *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Procesverbali i shqyrtimit kryesor, i datës 29.10.2019 në të cilin janë administruar provat si në vijim: Dëgjimi i dëshmitarëve K.B., T.G., Procesverbali i shqyrtimit kryesor, i datës 02.12.2019 në të cilin janë administruar provat si në vijim: Dëgjimi i dëshmitarit V.D. dhe L.Gj., Procesverbali i shqyrtimit kryesor, i datës 30.12.2019 në të cilin janë administruar provat si në vijim: Dëgjimi i palëve ndërgjyqëse në cilësi të palës, është bërë shikimi i shkresës së datës 30.01.2015, Leximi i regjistrimit të biznesit, Transaksioni bankar i datës 30.12.2019.

Gjykata pas vlerësimit të thënieve nga palët ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

- *Nga provat e administruara u argumentua gjendja faktike si me poshtë:*

Nga shikimi i shkresës së datës 30.01.2015 gjykata vërtetoi faktin se kjo shkresë është shkresë e shkruar me dorë e cila mban titullin Marrëveshje mbi huadhënije, në të është cekur se “Rr. B. i dha 40.000.00 Euro hua, ndërsa P. Gj. i muarr 40.000.00 Euro hua për blerje të viçave”. Më poshtë letra përmban emrin e P. Gj.t, numrin personal dhe nënshkrimin, ndërsa në anën tjetër përmban emrin e Rr. B.t dhe numrin personal dhe mungon nënshkrimi.

Nga Leximi i regjistrimit të biznesit gjykata vërtetoi faktin se biznesi N.T.P “. . .” është regjistruar me numër unik identifikues 810234336 dhe numër të biznesit 70126441 me emër të biznesit L.Gj. B.I me datë të regjistrimit 01.04.2004 me seli në Rr. E Tivarit, Gjakovë, me pronar L.Gj..

Nga transaskioni bankar i datës 30.12.2019 gjykata vërtetoi se është fjala për transaksion të dëshmitarit K.B. lidhur me kredinë në bankën TEB.

Paditësi Rr. B. i dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se V.D. dhe P. Gj. kanë ardh tek shtëpia ime. Unë atë vit jam ardhë në Kosovë, V. me P. Gj. kanë ardhur dhe më kanë lyp 40 mijë Euro hua për blerjen e viçave. V.n e kam dëgju që P. ju ka drejtua me D. P.. Në fillim ka deklaruar se nuk i ka pasur paratë por me insistimin e P. ai i ka siguruar paratë nga familja e tij, përkatësisht nga vëllau që ja ka dërguar 20 mijë euro dhe motra që ja ka siguruar 10 mijë euro dhe pasi ka siguruar paratë të njëjtat ja ka dhënë P., ku kemi shkruar një letër me dorë, prezent kanë qenë P.i, V. dhe K.. Detyrimi ka qenë që paratë me ja kthyer paditësit në afat prej 6 muajsh nga dorëzimi i tyre, mirëpo i padituri asnjëherë nuk i ka kthyer paratë. Ndërsa borxhin që ka marë nga vëllau dhe motra e ka paguar paditësi në vitin 2018, siç vërtetohet nga transferi i TEB Bankes. Ka deklaruar se nuk ka qenë i dënuar asnjëherë për fajde apo për përfitim jo proporcional.

I padituri P. Gj. i dëgjuar në cilësi të palës ka deklaruar se paditësin e njeh përmes ellsaut të tij K. dhe se djali i tij L.Gj. e ka një qendër bujqësore që merret me grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe me blegtori dhe gjatë bisedimeve me Rr. kemi shqyrtuar mundësinë që të më ndihmoj për zgjerim të biznesit për blerje të viçave dhe për të pasur Rr. një dëshmi para familjareve të vet i duhet një dëshmi dhe për atë është bërë një në letër si draft marrëveshje dhe ku është lënë që ai të ja sjell të paditurit brenda 2-3 ditësh paratë dhe ta finalizojnë marrëveshjen te noteri mirëpo një gjë e tillë nuk a ndodhur për shkak se nuk ka ardhur të m'i sjell paratë. Ka shtuar se në momentin e draft marrëveshjes ka qenë przent vetëm ai, Rr. dhe djali i tij që vinte kohë pas kohe dhe se T.G.n nuk e njeh ndërsa njeh V.n dhe K.. Në fund ka shtuar se paditësi ka shkuar në zyrë të djalit të tij duke i kërkuar fillimisht në emër të borxhit shumën prej 2000.00 euro, mandej prej 4,000.00, e dikur 6,000.00 euro.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka administruar procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 29.10.2019 ku në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar K.B. i cili ka deklaruar se në janar të vitin 2015 jam takuar me P. ku kam shkuar unë dhe vëllai Rr., T.G. dhe V.D. në zyrën e tij, pasi që Rr më ka thënë se mi ka lyp disa pare hua dhe para kësaj e kam parë që me V.n para kësaj kohe ka ardh e i ka lyp. Ja kemi qu paret në zyrën tek P i cili ka biznes për grumbullimin e grurit ku ia kemi dorëzuar 40.000 €, ku e ka nënshkruar një kontratë me vulë të veten P.. Afati i caktuar për kthimin e pareve ka qenë i caktuar afati 6 muaj, mirëpo i njëjti ka thënë se ka mundësi që ju kthej më përpara pasi që do ta bëjë dorëzimin e grurit në Silos. Sipas të paditurit i njëjti ka pas për qëllim mi marrë disa bika pasi që kishte hap një fermë dhe kishte marrë dhe një subvencion prej qeverisë, ndërsa ka shtuar se asnjë pjesë e borxhit nuk iu ka kthyer. Dëshmitari ka shtuar se po kam qenë së bashku me Rr. si dhe ka pas raste kur kam shkuar edhe vet dhe i njëjti është përgjigjur se do ti kthej shumë shpejtë duke thënë pritem edhe një muaj edhe një muaj. Ndërsa të hollat i ka marrë personalisht P., në marrëveshje është vendosur edhe vula e firmës e cila është vendosur për pare të cila ia ka dhënë hua, dhe firma ka qenë në emër të P.. Dëshmitari ka deklaruar se nuk ka qenë e caktuar data në marrëveshje pasi që i kemi besuar dhe se i njëjti ka deklaruar që do ti kthej brenda 6 muaj, kur ta dërgon grurin në Silos. Dëshmitari ka deklaruar

se kur janë dorëzuar të hollat ka qenë Rr., unë, V.D. dhe T.G. si dhe ka qenë personi L.Gj., mirëpo ai ka qenë punëtor dhe me rastin e dorëzimit të hollave nuk ka qenë në zyre. Lidhur me të hollat dëshmitari ka deklaruar se i ka mbledh Rr nga motrat dhe vëllezërit dhe i ka tubuar dhe ia ka dërguar. Unë personalisht kam marrë kredi 25.000 €, për me ju kthyer borxhin familjarëve, motrave dhe vëllezërve, pasi që i padituri nuk e kthente borxhin. Dëshmitari ka deklaruar se i kemi besuar dhe nuk e këna menduar se nuk do të na kthej të hollat, andaj dhe nuk kam nënshkruar si dëshmitar në atë marrëveshje.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka administruar procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 29.10.2019 ku në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar T.G., i cili ka deklaruar se P e njehepërmjet Rr. dhe V.t, e ka parë disa herë me V.n te Rr. në shtëpi, shton se unë kam qenë me K. duke ndejtur kur e ka thirrë Rr. dhe i ka thënë se duhet të shkojmë deri te P. Gj. për me shkuar te depo e mullirit, kam qenë unë, V.D., Rr dhe kur kemi shkuar aty kam kuptuar se bëhet fjalë për disa të holla, rreth 40,000 €, ku ia ka dhënë Rr, P. dhe i kam parë kur i ka nënshkruar në një cop letër dhe kam dëgjuar kur kanë biseduar për disa bika. Dëshmitari ka deklaruar se ka qenë huadhënie dhe afati i kthimit ka qenë për 6 muaj, unë kam qëlluar rastësisht. Ka shtuar se e njoh V.D. pasi që e kam komshi dhe rolin pak a shumë e ka pas si ndërmjetësues pasi që i njëjti e ka njohur më shumë P.. Ku V. ka thënë se është njeri i sigurve dhe do ti kthen të hollat. Afati për kthimin e të hollave ka qenë brenda 6 muajve dhe sa kam njohuri nuk është kthyer asnjë pjesë. Unë nuk e kam parë marrëveshjen, shton se i kam parë duke nënshkruar por nuk e di që përmbajtjen, lidhur me afatin e kthimit me gojë e kam dëgjuar, mirëpo në marrëveshje nuk e di që se çfarë kanë shkruar. Vendi ka qenë në depo tek P. në rrugën për Trakaniq. Atë ditë i kam parë të hollat dhe ka pas të ndryshme, mirëpo nuk mund të them saktë pasi që kanë kaluar shumë vite, nuk kam dijeni se a janë marrë në emër të firmës apo personalisht. I njëjti ka shtuar se paditësi punon si bujk ndërsa me herët ka qenë punëtor në Mal të Zi, dhe sipas bisedave që i kemi pas paditësi i ka marrë të hollat nga ana e familjarëve. Në zyre ka qenë P., V., unë dhe K., ka qenë edhe një person tjetër mirëpo ai ka dal jashtë, pasi që i ka thënë P

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka administruar procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 02.12.2019 në të cilin në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar V.D. i cili ka deklaruar se P e njeheq 7 vite, ndërsa Rr. B.n e kam kojshi dhe e njoh prej fëmijërisë, ndërsa palët janë njoftuar nëpërmjet meje. Dëshmitari ka deklaruar se me P. e kam mik që sa vite, ndërsa Rr. e kam kojshi dhe raportet me P. si shokë kanë qenë më të thella, pasi që e konsideroi edhe si dajë. Dëshmitari ka deklaruar se P. ju kanë nevojitur një shumë e të hollave, pasi që e kishte mbaruar stallën për viqa dhe i kam propozuar për të holla që të ia lyp Rr dhe unë kam biseduar me Rr dhe ja kam kërkuar të hollat për P, jam takuar nja dy tri herë me P dhe kemi shkuar te Rr dhe jemi takuar bashkë dhe i kam thënë se që të dy jeni njerëz të mirë dhe ki mundësi Rr mi krye punë. Njëherë Rr. nuk i ka dhënë se ka deklaruar se nuk kam pastaj jemi takuar prapë dhe i kam thënë Rr. jepja, se e kam ditë se i ka disa të holla për stallë të vetë, pastaj prapë jemi takuar dhe ia ka dhënë, ku ia ka dhënë 40.000 €. Pranim dorëzimi i të hollave është bërë tek P. – vend punimi i tij, ka qenë viti 2015 muaji parë. Dëshmitari ka deklaruar se po kam qenë prezentë dhe të hollat janë numëruar dhe janë dhënë kesh, kanë bërë me shkrim marrëveshjen, pasi që për këtë kishte vullnet edhe P. dhe afati i kthimit ka qenë brenda 6 muajve, roli im ka qenë se e kam njoftuar dhe kam ndërmjetësuar dhe ka shtuar se nuk janë kthyer të hollat. Dëshmitari deklaroi se po ka kontaktuar Rr. me mua disa herë dhe kam biseduar me P. dhe i njëjti më ka thënë se do të ia kthejë qe një

muaj qe dy muaj të hollat i ka kërkuar në emër të vetin. Marrëveshja është bërë me shkrim me dorë dhe të njëjtin e ka shkruar vetë P. Gj.. Kur është bërë pranim dorëzimi i pareve kanë qenë prezentë unë, Rr, K.B. dhe T.G. dhe P. i cili i ka pranuar të hollat. Dëshmitari ka deklaruar se ka nënshkruar P. Gj. ndërsa të tjerët nuk ka lejuar mi nënshkruar, pasi që kanë qenë njerëz të besueshëm. Lidhur me sigurimin e të hollave se një pjesë të hollave e ka pas ndërsa pjesën tjetër nuk e di se ku e ka siguruar. Pronar i firmës ka qenë L.Gj., djali i P., Rr. nuk e ka nënshkruar marrëveshjen pasi që P. e ka bërë vetë këtë marrëveshje, pasi që ne i kemi thënë se nuk ka nevojë me bërë këtë marrëveshje, andaj edhe Rr. nuk e ka nënshkruar, ndërsa të hollat janë dhënë dhe nuk ka pas ndonjë mosmarrëveshje. I njëjti ka deklaruar se L.Gj. nuk ka qenë atë ditë në zyre, ndoshta ka ndonjë punëtor i P..

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka administruar procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 02.12.2019 në të cilin në cilësinë e dëshmitarit është dëgjuar L.Gj., i cili ka deklaruar se me datë 30.01.2015, Rr. ka ardh në zyre tek unë vetëm dhe i kam dëgjuar duke biseduar me babain tim për një marrëveshje e cila nuk është jetësuar kurrë. Pra kjo marrëveshje e cila është shkruar me shkrim, është biseduar për blerjen e disa viçave, e cila marrëveshje ka qenë rreth 40.000 € të cilat të holla ka pas Rr. mi sjellë dhe të cilat nuk janë sjellë asnjëherë dhe po të silleshin ato të holla do të kërkoja që të njëjtat të transferohen nëpërmjet bankës. Marrëveshjen e ka nënshkruar vetëm P., ndërsa Rr. nuk e ka nënshkruar se pasi që i njëjti nuk i ka sjellë të hollat dhe do të kërkoja që e njëjta të vërtetohet tek noteri. Të hollat supozohet se kanë qenë të në emër të P. dhe nuk ka qenë askush prezentë. Ka shtuar se V.n dhe K. e njoh ndërsa T.G.n nuk e njoh dhe asnjëri nuk kanë qenë prezentë. Ka shtuar se në rast se ishte arritur marrëveshja atëherë afati i kthimit ka qenë 6 muaj. Firma ime merret kryesisht me prodhime bujqësore nëse ishte marrë borxhi kemi pas për qëllim zgjerimin e biznesit. Marrëveshjen e ka shkruar babai im P.. Me rastin e shkrimit të marrëveshjes Rr ka pas mi sjell kotë të holla shumë shpejt, se kanë qenë biseda pas sjelljes së të hollave e cila ka qenë afati shumë shpejtë një ditë apo dy dhe afati i kthimit ka qenë 6 muaj. Dëshmitari ka shtuar se tek zyret nuk kemi kamera të sigurisë dhe Rr. është duke e keq përdorë këtë të mirë të cilën ia ka bërë P., duke ia nënshkruar këtë marrëveshje për mbulimin e disa të hollave tjera.

- *Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës*

Gjykata pas vlerësimit dhe analizimit të provave të lartcekura dhe duke iu referuar bazës ligjore erdhi në përfundim se kërkesë-padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Deri tek një përfundim i tillë, gjykata erdhi pasi që nga analizimi i përmbajtjes së shkresës së datës 30.01.2015 konstatoi se në këtë shkresë vetëm është cekur shuma prej 40.000.00 Euro, nuk është cekur mënyra e dorëzimit dhe afati i kthimit, madje kjo shkresë nuk është e nënshkruar fare nga paditësi, por vetëm nga i padituri, këtë fakt nuk e mohon as vetë e autorizuara e paditësit kur në seancë deklaroi se: *“ndërsa aq sa e kam parë unë, e njëjta marrëveshje nuk është e nënshkruar nga ana e paditësit”* dhe shton se *“shtoj faktin se paditësi është person laik”*, e po ashtu edhe paditësi gjatë dëgjimit të tij në cilësi të palës ka konfirmuar se nuk e ka nënshkruar këtë marrëveshje.

Po ashtu, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë faktin nëse shuma prej 40.000.00 Euro, e cila pretendohet në marrëveshje të jetë dorëzuar të paditurit, vërtetë i është dorëzuar të njëjtit, kjo ngase edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve gjykata nuk ka mundur të vërtetojë këtë fakt, e po ashtu nuk ka mundur të vërtetoi edhe mënyrën e dorëzimit të këtyre parave.

Gjykata gjeti se deklaratimet e paditësit janë kontradiktore me deklaratimet e dëshmitarëve kur jemi te qëllimi i dhënies hua dhe mënyrës së dhënies së kësaj shume, ku të njëjtit deklarojnë se paditësi i ka mbledhur paratë nga familjarët e tij, duke i marrë borxh motrës dhe vëllait të tij, për t'i dhënë hua të paditurit dhe atë për një afat prej 6 muajsh, gjë që për gjykatën është tejet konfuze se pse paditësi paska hyrë borxh tek familjarët e vet, vetëm për t'i dhënë të paditurit hua shumë prej 40.000.00 Euro.

Prandaj nga këto fakte të vërtetuara dhe duke iu referuar Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përkatësisht nenit 567, ku është paraparë se: *“Me kontratën e huas huadhënësi obligohet t'ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë”*, gjykata gjatë këtij shqyrtimi nuk ka arritur të vërtetojë kushtin themelor që të konsiderohet e lidhur një kontratë huadhënie, ngase nuk ka arritur të vërtetojë se huadhënësi ia ka dorëzuar huamarrësit shumë e caktuar të hollave, ashtu siç pretendohet të jenë marrur vesh sipas marrëveshjes së datë 30.01.2015.

Duke u nisur nga neni 7 i LPK-së ku thuhet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* dhe neni 322 i LPK-së, përkatësisht paragrafi 1 i cili përcakton se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, e në rastin konkret gjykata konsideron se barra e provës bie mbi paditësin, i cili me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme dhe të bazueshme kërkesën e tij, edhe pse paragrafi 2 i po këtij neni decidivisht përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, paditësi në këtë shqyrtim nuk i ka ofruar asnjë provë gjykatës se me të vërtetë ka qenë në posedim të parave, pasi që gjykata nuk ia fali besimin pretendimit të paditësit se paratë i ka marrë hua nga familjarët e tij. Edhe po të ekzistonin këto para, me asnjë provë nuk është vërtetuar se këto para i janë dorëzuar të paditurit, ku gjykata nuk ua fali besimin deklaratimeve të dëshmitarëve pasi që për gjykatën të njëjtit nuk kanë qenë bindës, nuk kanë arritur ta përshkruajnë shumë e parave, mënyrën e dorëzimit, përkatësisht formën e bankënotave, pasi që kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme prej 40.000.00 Euro, e po ashtu janë tejet kontradiktore për takimin kur janë dorëzuar paratë duke dhënë deklaratime të ndryshme lidhur me personat prezentë, përkatësisht me prezencën e dëshmitarit L.Gj., i cili sipas informatave të biznesit është pronar i NTP “Qendra e Biznesit” e madje e identifikojnë si punëtorë, të cilin kinse në momentin e dorëzimit i padituri e ka nxjerrë jashtë nga lokali që të mos jetë prezent.

Ndërsa lidhur me pretendimin e të autorizuarit të të paditurit se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës gjykata gjen se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar, sepse për

kontratën mbi huanë vlen afati i përgjithshëm i parashkrimit sepse për këtë kontratë nuk është përcaktuar asnjë afat tjetër i parashkrimit dhe prandaj vlen afati i përgjithshëm, i paraparë me nenin 352 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku është përcaktuar se *“Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.”* Dhe duke qenë se nga provat e sipërcituara ndërgjyqësit kanë lidhur marrëveshje (të pretenduar si kontratë) me datë 31.01.2015, ndërsa padia e kësaj gjykate është parashtruar me datë 12.11.2018 (data e padisë vërtetohet përmes vulës së pranimit të kësaj gjykate të vendosur në faqen e parë të padisë) atëherë gjykata gjeti se që nga koha e krijimit të raportit juridik, të pretenduar, në mes të ndërgjyqësve e deri në paraqitjen e padisë nuk kanë kaluar 5 vite për tu arritur afati i parashkrimit të kërkesës së paditësit.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që nuk kanë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast të paditurit ju pranuar shpenzimet në shumë prej 3,120.00 Euro, të cilat i referohen përgjigjes në padi në shumë prej 208.00 euro, përgjigjes në ankesë në shumë prej 208.00, përfaqësimit për 8 seanca gjyqësore të mbajtura në shumë prej 2,163.20 euro ($8 \times 270.40 = 2,163.00$), ndërsa shumë e mbetur prej 540.80 euro i referohet përfaqësimit për katër seanca të shtyra gjyqësore ($4 \times 135.520 = 540.80$).

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më larte, bazuar në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2019:079010, datë 11 korrik 2024.

Gjyqtarja,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.